



MINISTRI I MJEDISIT IU DREJTOHET 61 BASHKIVE: NGA 1 JANARI 2017 PËRGEJGJËSE PËR SHITJEN E LËNDËS DRUSORE PËR NGROHJE

“Parlamenti Shqiptar miratoi në Maj 2016, Ligji nr 48/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9385 datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”.

Me këtë vendim historik iu hap rruga njëres prej reformave më jetike në fushën e pyjeve dhe kullotave për vendin tonë, për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve, krahas miratimit të ligjit “Moratoriumi 10-vjeçar i pyjeve”, hyrë në fuqi në 11 Shkurt 2016. Ky ligji i amenduar ishte rezultat i një konsultimi të gjatë me specialistë të fushës, me njësitë e qeverisjes vendore, me përfaqësues të botës akademike, partnerët tanë ndërkombëtarë dhe aktorë të ndryshëm në fushën e mjedisit.

Ky ligj solli riorganizimin e qeverisjes së fondit pyjor dhe kulloros kombëtar, duke ngarkuar Ministrinë me funksion politikbërës duke dhënë një drejtim të ri menaxhimit të fondit pyjor dhe kulloros publik. Funksionet menaxhuese dhe administrative të fondit pyjor dhe kulloros kombëtar, i janë ngarkuar prej 6 muajve Bashkive, ndërsa funksionet kontrolluese mbeten atribut i Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve. Ky ishte një progres thelbësor. në kuadër të decentralizimit të kompetencave nga qeveria qendrore drejt asaj vendore, në përputhje të plotë me strategjinë ndërsektoriale të decentralizimit.

Pushteti vendor është i lidhur në mënyrë të drejtëpërdrejtë me çdo aspekt të jetës së qytetarëve që ju kanë votuar. Pushteti që ju ushtroni, prek më nga afër nevojat jetike të gjithësecilit duke pasur përgjegjësinë që të ofrojë zgjidhje për shqetësimet që ka çdo banor dhe familja e tij, në zonën ku ai banon.

Duke marrë në konsideratë këtë moment tejet të rëndësishëm për mbarë vendin, dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj rëndësinë e ekonomisë pyjore të Bashkisë suaj dhe furnizimit me dru zjarr për ngrohje të popullatës. Për këtë arsye, ju nxis të shihni si prioritet Pyjet dhe Kullotat, që ju sot menaxhoni dhe administroni, si një aset të vyer ekonomik, me ndikim të drejtëpërdrejtë në nxitjen e punësimin, fuqizimin e ekonomisë lokale, zhvillimin e turizmit dhe në zbutjen e efekteve nga ndryshimet klimatike, si parandalimin e erozionit dhe përmbytjeve.

Në këtë kuadër sjell në vëmendjen tuaj, se legjislati parashikon një sërë veprimesh që duhet të ndërmerren

nga ju, për të siguruar për qytetarët që qeverisni një cilësi jetese më të mirë. Qeveria Shqiptare për t’ju dhënë kohën e nevojshme për të qenë gati për këtë sezon dimëror, përmes VKM Nr. 438 Datë 08.06.2016 lejoi funksionimin e operatorëve privatë për prodhimin dhe shitjen e lëndës drusore, deri në datë 31 Dhjetor 2016 paralelisht me strukturat e ngritura nga Bashkia.

Është e rëndësishë së veçantë, të kërkoj vëmendjen tuaj se bazuar në dispozitat kalimtare ligjore të parashikuara në këtë VKM, nga data 01 Janar 2017, Bashkia do të jetë i vetmi subjekt përgjegjës për shitjen e lëndës drusore me qëllim furnizimin e popullatës me lëndën drusore për ngrohje. Sikurse parashikohet në VKM-në e sipërcituar, përgjegjësia për furnizimin e popullatës me dru zjarr për ngrohje është kompetencë e vetme e Bashkisë që ju drejtoni. Bashkia identifikon nevojat, përcakton ngastrat dhe zonat pyjore të prodhimit, kërkon pranë Ministrisë së Mjedisit e tyre dhe realizon shitjen e druve të ngrohjes së popullatës.

Për këtë, kuadri ligjor, siç edhe jeni njohur, ju jep të drejtën të realizoni prodhimin përmes 2 alternativave:

1. Duke prodhuar drutë e zjarrin përmes procesit të shfrytëzimit me një operator privat, tenderimin e këtij shërbimi, në pamundësi të ngritjes së ndërmarrjes publike bashkiake për këtë qëllim. Sipas kësaj alternative Bashkia pasi ka miratuar vendet e caktuara për prodhimin e lëndës drusore, mund të tenderojë shërbimin e prerjes dhe të transportit të afërt të lëndës drusore. Transporti i largët deri në sheshin e paracaktuar për shitje nga Bashkia është përgjegjësi e vetme e juaja; ose,

2. Ngritja e Ndërmarrjes Publike Bashkiake për prodhimin e druve të zjarrin përmes procesit të shfrytëzimit. Në këtë alternativë Bashkia është përgjegjësjë e vetme për shfrytëzimin, transportin dhe shitjen e sasisë tek popullata

Ndërkaq shitja e materialit drusor, me qëllim të vetëm dhe të patjetërsueshëm ngrohjen e popullatës, sipas këtij kuadrit ligjor në të dyja rastet e sipërpërmendura duhet të kryhet vetëm nga Bashkia.

Ligji ju detyron, që çdo e ardhur që realizohet nga ky proces, të alokohet në masën 100% për shtimin e fondit pyjor dhe zonave të degraduara në këtë fond me qëllim rigjenerimin dhe shëndetësimin e ekonomisë pyjore, për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të këtij fondi.

Ju sjell në vëmendje gjithashtu, se për vitin 2017 dhe në vijim, mundësia vjetore e shfrytëzimit të pyjeve që kërkohet nga ana juaj për prodhimin e lëndës drusore duhet të jetë e bazuar në objektivat e planit të mbarëshimit të ekonomisë pyjore. Në asnjë rast, miratimi nga ana e Ministrisë së Mjedisit, nuk do të jepet nëse nuk do të paraqisni një plan menaxhimi të miratuar.

Ministria e Mjedisit, prej 1 viti tashmë ka qenë në angazhim të drejtëpërdrejtë maksimal dhe serioz me strukturat drejtuese të Bashkisë suaj, për të siguruar transferimin e suksesshëm të fondit pyjor dhe kulloros, nën përgjegjësinë e administrimit nga ana e Bashkisë.

Me gjithë problematikat e vërejtura gjatë kësaj periudhe 12 mujore, Ministria e Mjedisit beson fort, se ky proces është në dobinë e drejtëpërdrejtë të fuqizimit ekonomik të Bashkisë dhe rritjes së mirëqenies për qytetarët që ju drejtoni.

Ju falenderoj për mirëkuptimin dhe ju siguroj se Ministria e Mjedisit do të vazhdojë të jetë një mbështetës e partner i dedikuar krahu jush, për të siguruar një mjedis të shëndoshë për të gjithë qytetarët shqiptarë.



URIMET PËR NJË VIT TË MBARË: MINISTRI I MJEDISIT ME FEMIJËT E PUNONJËSVE TË MINISTRISË

Në prag të festave të fundvitit, Ministri i Mjedisit Z. Lefter Koka priti fëmijët e punonjëseve të Ministrisë së Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve si dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Ambientet e Ministrisë së Mjedisit dhe zyra e punës së Ministrisë Koka për disa minuta u pushtuan nga zërat e fëmijëve të cilët vizituan ambientet e



brendshme dhe morën dhuratat e përgatitura enkas për ta.

Ministri Koka u shprehur fëmijëve

dhe prindërve të tyre urimin për një vit të mbarë dhe me ëndrra të realizuara.



“Punojmë bashkë me prindërit tuaj, që ju të gëzoni më

shumë dhe jo vetëm në ditë festash! Punojmë që ta kemi Shqipërinë sa më të pastër dhe të bukur kështu siç jeni edhe ju! Ndaj unë ju uroj që vitin e ardhshëm ta keni sa më të mbarë, të jeni sa më të mirë në shkollë, sa më të sjellshëm në familje dhe

në qytet. Qoftë viti që vjen plot me dashuri dhe mirësi në familjet tuaja!”- tha ministri Koka. Më pas Ministri Koka së bashku me fëmijët ndezën dritat e Pemës së Krishtlindjes dhe Vitit të Ri të vendosur në ambientet e jashtme të Ministrisë së Mjedisit duke simbolizuar kështu hapjen e sezonit festiv të fundvitit.



NË KËTË NUMËR:

MINISTRI I MJEDISIT IU DREJTOHET 61 BASHKIVE: NGA 1 JANARI 2017 PËRGEJGJËSE PËR SHITJEN E LËNDËS DRUSORE PËR NGROHJE -FQ.1

ÇELËT FUSHATË KOMBËTARE E PYLLEZIMIT NË ERSEKË- FQ 4

4 MINISTRA TË QEVERISË SHQIPTARË BASHKË PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM TË ZONAVE TË MBROJTURA- FQ 5

MBLIDHET GNP: AMENDIMET NË KODIN PENAL PËR KRIMET MJEDISORE

“Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritimit të vendit në Bashkimin Evropian. Përbushja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxitur dhe bashkërenduar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqenie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionin publik”.

ÇELET FUSHATA KOMBETARE E PYLLEZIMIT NË ERSEKË



Kolonjë- 40 Milionë Lekë të reja investim për gjelbërimin publik në Ersekë Në kuadër të Fushatës Kombëtare të Pyllezimit, Ministri i

Mjedisit, Z. Lefter Koka ka nisur inspektimet në bashki të ndryshme të vendit me qëllim mbështetjen e projekteve për mbjelljen e fidanëve të rinj por edhe inspektimin e situatës së pyjeve në rang vendi. Për të celur fushatën e pyllezimit, Ministri Koka ishte i pranishëm në bashkinë e Kolonjës. Në shoqërinë e kreut të kësaj bashkie, z. Ila Stefo, Ministri Koka inspektoi projektin e gjelbërimit publik të Ersekës dhe mbolli simbolikisht fidanin e parë të këtij projekti, një investim prej 40 milionë lekësh të reja të Ministrisë së Mjedisit, që përfshin gjelbërimin e të gjitha akteve kryesore të qytetit, unazës së tij si dhe të dy shkollave të Ersekës me 6 mijë fidanë dru shkurre dhe lule dekorative. Gjatë fjalës së tij Ministri Koka uroi së pari kryetarin Stefo për detyrën e re: “Kryetarin e ri e presin punë, me të cilat ai duhet t'i kthejë Kolonjës vlerat e saj. I uroj suksese në këtë detyrë të vështirë por edhe të bukur”- tha ministri Koka. Duke iu referuar zbatimit të moratoriumit të pyjeve dhe ngrohjes me dru të popullatës Ministri Koka apeloj sërish kryebashkiakët e vendit: “Pyjet që sot janë në menaxhim të bashkive duhet të kuptojnë se është aset ekonomik i rëndësishëm. Ngrohja me dru zjarri dhe furnizimi popullatës në zonat e thella duhet të jetë prioritet për Bashkinë.” Më tej Ministri

Koka theksoi edhe rëndësinë e zhvillimit të agroturizmit në këtë zonë të vendit. “Uroj që të mbarojë rruga sa më shpejt për të zhvilluar zonën drejt agroturizmit, pasi natyra këtu ka treguar të gjithë bujarinë e saj” - tha Ministri Koka. Nga ana e tij, kryebashkiaku Stefo u shpreh se pyjet janë prioritet i bashkisë që ai drejton: “Jam i kënaqur që po rikthejmë traditën në Kolonjë. Pyllezimi dhe gjenierimi i zonave të degraduara pyjore është një nga prioritetet kryesore të Bashkisë që unë drejtoj” Projekti “Gjelbërimi i mjediseve publike të qytetit Ersekë” pritet të mbarojë në fund të këtij muaji.

Ministri Koka nga Përmeti, Qyteti Trëndafilave: “Mirënjohje për Kryetarin e Bashkisë së Përmetit. Është modeli më i mirë i bashkëpunimit të pushtetit vendor me atë qendror”

Ministri i Mjedisit z. Lefter Koka inspektoi nga afër investimin e Ministrisë së Mjedisit prej rreth 10 milionë lekë të reja, në qytetin e Përmetit, në kuadër të Fushatës Kombëtare të Pyllezimit, që çeli 1 ditë më parë në Ersekë. I shoqëruar nga Kryetari i kësaj bashkie, z. Niko Shupuli, Ministri Koka inspektoi projektin e gjelbërimit të mjediseve publike të Përmetit dhe mbolli simbolikisht fidanin e parë të këtij projekti, që përfshin gjelbërimin e të gjitha akteve kryesore të qytetit, me 2 mijë fidanë dru shkurre dhe lule dekorative.

Ministri Koka deklaroi: - “Mirënjohje për Kryetarin e Bashkisë së Përmetit. Është modeli më i mirë i bashkëpunimit të pushtetit vendor me atë qendror”

Në vijim të prononcimit të tij, ai deklaroi: - “Në këto zona ka nisur një frymë e re. Bashkëpunimet tona me Bashkinë Përmet janë shumë dimensionale e në disa sektorë, ku vlejnjë të theksohen ato në trajtimin e mbetjeve apo menaxhimin e pyjeve, 2 sektorë shumë të rëndësishëm për shëndetin qytetarëve . Në Përmet duhet të zhvillohet edhe më tej turizmi e t'i kthehet tradita këtij qyteti”

Kryetari Shupuli falenderoi Ministrin Koka për mbështetjen e dhënë për këtë projekt. Ai e cilësoi këtë projekt si bashkëpunim të frytshëm mes Ministrisë së Mjedisit dhe Bashkisë Përmet. Shupuli në falën e tij deklaroi: - “Faza e parë e projektit tonë në akset kryesore për mbjelljen e 2000 copë druve dekorative, luleve, bar dhe shkurre u mbështet nga Ministria e Mjedisit. Nga këto janë pjesë e projektit mbjellja e 1000 trëndafilave për t'i dhënë emrin e merituar Përmetit si Qyteti Trëndafilave”.

Ai e mbylli deklaratën e tij me kërkesën për mbetjen nga Ministri Koka për fazën 2 të projektit të gjelbërimit publik: - “Kërkoj mbështetjen për fazën e dytë të projektit për gjelbërimin e rrugëve të brendshme brenda lagjeve dhe parkut të qytetit të Përmetit”.

MINISTRI I MJEDISIT PRET KREUN E PREZENCËS SË OSBE-SË NË SHQIPËRI

Ministri i Mjedisit, Z. Lefter Koka priti në një takim Kryetarin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri Z. Bernd Borchardt. Ministri Koka e njohu Z. Borchardt me progresin në fushën e mjedisit në këto tre vite, si dhe prioritetet dhe objektivat kryesore të Ministrisë, ku veçoi reformat e thella administrative të ndërmarra, që sollën ngritjen e tre institucioneve; Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

Në vijim Ministri Koka theksoi dhe reformat e ndërmarra

për mbrojtjen e Mjedisit, si moratoriumet në fushën e pyjeve dhe gjetiesë dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Gjatë takimit, diskutimi u fokusua në punën që Ministria e Mjedisit ka bërë deri tani për ndryshimet e kodit penal për krimin mjedisor. Gjithashtu, u vu në pah fakti që Ministria e Mjedisit ka bërë një progres të dukshëm në përfundimin e legjislacionit mjedisor në masën e 90% me legjislacionin e Bashkimit Europian.

Gjatë takimit Z. Borchardt shprehu konsideratën e tij për

punën e bërë deri tani në sektorin e mjedisit dhe theksoi veçanërisht angazhimin e kontributin e OSBE –së për mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes mjedisore në vend. Ministria e Mjedisit prej vitit 2015 është duke punuar për amendimet e Kodit Penal për përgatitjen e një Paketi të Krimin Mjedisor, në bashkëpunim të ngushtë me ekspertë vendas, ekspertë dhe konsulentë të huaj, si dhe aktorë kryesorë të përfshirë në këtë proces.



VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS 2016

Nr.	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Vendimi	Hartoi
1	R.B.ITALBETON	VP “Ndërtim impiant fraksionimi inertesh” Bashkia Vlorë	Rr. “Damian Humariti”, Bashkia Vlorë	Vendim për VNM Paraprake	Lura Studio
2	Invictus	VP “Projekt zbatimi i HEC-it Bregu i Lerës” në përronin e Mezgoranit, Tepelenë	Tepelenë, Qarku Gjirokastrë	Vendim për VNM Paraprake	Andrin Kërpaçi
3	GIB	VTH Shfrytëzim mineral gure gelçeror me karriere	Bicaj, Kukës	Plotësim Informacioni	Studio Projekt
4	Albanian Stone Factory	VP Stabiliment perpunim prodhim guri	Bulgarec, Korçë	Vendim për VNM Paraprake	Demir Kullolli
5	Bashkia Korçë (FZHSH)	VP Qendër polifunkionale e shërbimeve, kreativitetit dhe kulturës në qytetin e Korçës	Bashkia Korçë	Vendim për VNM Paraprake	Arben Muha
6	Pali	VP Qendër multifunkionale kërkimore për zhvillimin e turizmit (Kompleks turistik)	Lugina e Patokut, Laç, Lezhë	Vendim për VNM Paraprake	Lura Studio
7	Vilson Masmalaj	VTH Kompleks blegtoral	Bërdicë, Shkodër	Deklaratë Mjedisore	Eko Studio
8	Altin Ceci	VP Prodhim pije alkoolike	Gurishte, Maliq, Korçë	Shkresë	Demir Kullolli
9	Milenium	VP Prodhim betoni	Pojan, Korçë	Vendim për VNM Paraprake	Gavrosh Zela
10	Bashkia Himarë	VP “Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura”	Dhralë, Himarë, Vlorë	Vendim për VNM Paraprake	Liljana Vllamasi
11	Enti Kombëtar i Banesave	VP Objekt Banimi social 6 kt	Bashkia Durrës	Vendim për VNM Paraprake	Razie Naipi
12	Bashkia Divjake	VP Rikonstruksion shkolle	Cerem, Divjakë	Vendim për VNM Paraprake	Gjergj Lici
13	MTI	VP Kolektori e impianti i ujërave te zeza	Gjiri i Lalëzit, Durrës	Vendim për VNM Paraprake	Eko Studio
14	Bonita	VP Rikonstruksion dhe shtese shërbimi, parkim hoteli	Golem, Kavajë	Vendim për VNM Paraprake	Hamdi Hoti
15	Umranije	VP Konvikt humanitar	Pukë, Shkodër	Vendim për VNM Paraprake	Lura Studio
16	D&A”	VP Ndërtim kapanoni industrial 1 kat	Bashkia Shijak, Durrës	Vendim për VNM Paraprake	Nevjana Isufi
17	VËLLEZËRIT HYSA	VTH “Shfrytëzim i gurit gelçeror në sipërfaqen shtesë të lejes minerare nr.1304/2, objekti “Rrezlikë”	Elbasan	Vendim për VNM të Thelluar	Studime Projektme Gjeologji - Inxhinjerike Hidrologji Mjedisore
18	VËLLEZËRIT HYSA	Shfrytëzim i inerteve lumore në zonën Pazhok” lumi Devoll,	Elbasan	Plotësim Informacioni	Studime Projektme Gjeologji - Inxhinjerike Hidrologji Mjedisore

4 MINISTRA TË QEVERISË SHQIPTARE BASHKË PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM TË ZONAVE TË MBROJTURA



Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura zhvilluan sot Forumin Koordinues “Rrjeti i Zonave të Mbrojtura: Modeli i ardhshëm i zhvillimit të qëndrueshëm – hapat e mëtejshëm për një menaxhim më të mirë”.

Ky forum mbledhi në një panel 4 Ministra të Qeverisë Shqiptare, z. Edmond Panariti, Ministër i Bujqësisë, Zj. Eglantina Gjermeni, Ministër i Zhvillimit Urban dhe Zj. Milva Ekonomi, Ministër i Ekonomisë, si dhe përfaqësuesit më të lartë të organizatave partnere e donatore UNDP, Delegacioni Evropian, GIZ etj

Në fjalën e tij Ministri Koka u ndal në 3 vite mjedis në përgjithësi dhe theksoi se zonat e mbrojtura në veçanti janë kthyer në qendër të vëmendjes së opinionit publik dhe komunitetit që jeton pranë tyre, falë politikës mjedisore të ndjekur nga qeveria shqiptare.

Deri më sot sipërfaqja e zonave të mbrojtura është mbi 16 % ndërsa deri në vitin 2020 synohet të arrihet mesatarja e standardit evropian, prej 17 % . Duke iu referuar projektligjit të ri të zonave të mbrojtura, Ministri Koka nënvizoi: “Nga konsultimet dhe dëgjësat me qytetarët, ekspertët, partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët ka një rëndësi të veçantë propozimi që çdo e ardhur që gjenerohet nga aktivitetet që ushtrohen në këto zona të mbrojtura të menaxhohen direkt nga AKZM. Kjo pavarësi dhe ndry-

shim i propozuar për menaxhimin financiar të të ardhurave në rast se do të miratohej do të conte zonat e mbrojtura në një të ardhme të afërt drejt një standardi evropian menaxhimi”. Ministri Koka theksoi gjithashtu se viti që po mbyllet ka shënuar një progres të dukshëm në zhvillimin e zonave të mbrojtura, ku qeveria shqiptare ka investuar 1 milionë dollarë në ngritjen e 10 qendrave të informacionit në zonat e mbrojtura. “Kemi një rritje të konsiderueshme të turistëve në zonat e mbrojtura dhe shifra impresionuese, 3.3 herë më shumë në 2016 krahasuar me 2015. Më duhet të shpreh kënaqësinë time që këtë vit kemi parë të kemi prezent si turistë, në këto zona edhe qytetarët shqiptarë që fatkeqësisht pak i kanë njohur deri tani mrekullitë e vendit”, tha ai.

Një ndër arritjet që shënohet gjatë këtij viti në fushën e zonave të mbrojtura është edhe realizimi për herë të parë me standarde të inventarizimit të florës dhe faunës së egër në Shqipëri ku Ministri Koka tha se brenda 2017 do të prezantohet për herë të parë me një standard dhe metodikë të njëjtë si vendet e zhvilluara , statistika e saktë e faunës së egër në vendin tone. Investimet në zonat e mbrojtura janë kryer edhe nga donatorë të huaj në vendin tonë, ku gjatë 2016 janë investuar rreth 6 milionë euro ndërsa vitin e ardhshëm do të vijojnë investime dhe deri më tani janë parashikuar rreth 3 milionë euro

zonave të mbrojtura, për ngritjen e standardeve dhe zhvillimin Drejtori i Përgjithshëm i AKZM z. Zamir Dedej në

prezantimin e tij theksoi se: - “Objektivi ynë madhor është të kalojmë nga kontrolli, që deri tani ishte prioritar drejt menaxhimit, për të zhvilluar dhe nxitur kështu zonat e mbrojtura”. Në sajë të investimeve të buxhetit të shtetit dhe organizmave të huaja po realizon për herë të parë inventarizimin e florës dhe faunës së egër në Shqipëri. Do të vendosen mbi 200 kamera kurth, të cilat do të ndihmojnë për monitorimin e faunës së egër brenda Zonave të Mbrojtura. Ndërkohë është ngritur për herë të parë sistemi elektronik BIONNA, data-bazë ku AKZM dhe 12 AdZM-të dhe ekspertët të fushës hedhin të dhënat kombëtare të biodiversitetit, të cilat janë tashmë të aksesueshme përmes faqes së internetit “Rrjeti Kombëtar i Biodiversitetit të Shqipërisë” (BioNNA). Me mbarimin e këtij viti do të jetë gatë edhe programi për monitorimin e faunës së egër në shkallë vendi dhe deri në fund të vitit të ardhshëm programi i monitorimit do të jetë i implementuar me të gjithë elementët.

Ndërkohë, brenda dy vitesh është investuar dhe po investohet fuqishëm në bërjen funksionale të mbi 10 qendrave informacioni/vizitorësh.

Për vitin 2017 objektivi kryesor është krijimi dhe përmirësimi i infrastrukturës në harmoni me rritjen dhe kërkesat e turistëve në Zonat e Mbrojtura. Kjo do të shoqërohet me rritjen e pranisë dhe asistencës së stafit në terren duke prezantuar dhe drejtuar turistët në zonat e mbrojtura.

KONVENTA E AARHUS-IT BËN BASHKË QEVERI QENDRORE, DONATORË DHE BOTËN AKADEMIKE

Ministria e Mjedisit, UNDP dhe Universiteti Politeknik i Tiranës nënshkruan sot një memorandum mirëkuptimi me qëllim intensifikimin e bashkëpunimit midis institucioneve në fushën mjedisit. Memorandumi u firmos nga Ministri i Mjedisit, Z.Lefter Koka, Drejtorja UNDP-së, Znj.Lilya Eltayeb dhe Rectori i Universitetit Politeknik të Tiranës, Prof. Dr. Z. Andrea Maliqari

Në kuadër të këtij memorandumit Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Tiranës dhe PNUD shpallë sot konkursin “365 orë për mjedisin” për projekt-ide të më të mira për projektimin e brendshëm të katit të parë të godinës së Ministrisë së Mjedisit dhe ambjenteve të jashtme të tij, duke aplikuar teknologji të reja inovative promjedisore. Thelbi i kësaj marrëveshje është që të bashkëpunohet në promovimin e projekteve novatore arkitekto-re me orientim ndërtimin e gjelbërt duke nxitur studentët në zbatimin e parimeve të shkencës së shëndoshë të ndërtimit, për krijimin e projekteve me kosto të arsyeshme dhe të gatshme për treg, në përputhje me kërkesat e Konventës Aarhus dhe Marrëveshjet Shumëpalëshe për Mjedisin të lidhura me të. Ministri

Koka në këtë takim vuri theksin në vizionin e tij për bashkëpunimin me gjithë aktorët në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut në çështjet mjedisore, si dhe përfshirjen e publikut në vendimarrje. Në këtë takim ai nënvizoi: - “Mjedisin nuk është ai që do të donim, vetëm me punën e një Ministrie, nëse mjedisin nuk mbështetet nga qytetarët. Ndryshimi tërësor i sjelljes sonë kundrejt tij është i domosdoshëm”.

Drejtoresha e UNDP-se në Shqipëri Znj. Eltayeb theksoi rëndësinë e angazhimit dhe rolit aktiv të duhet të kenë brezat e rinj duke dhënë kontribut direkt për çështjet mjedisore. Nga ana e saj ajo siguroi se UNDP në Shqipëri do të vazhdojë mbështetjen e iniciativave në këtë drejtim.

Rectori Maliqari falenderoi Ministrin Koka për konkretizimin e bashkëpunimit duke vënë theksin se fakulteti disponon potencialin më të aftë dhe specialistët më të mirë në shumë aspekte mjedisore.

Në këtë projekt do të përfshihet edhe projektimi për Qendrën e Informacionit Aarhus, me zyrë në Ministrinë e Mjedisit të Shqipërisë.

Konkursi ku marrin pjesë studentët e vitit të 5-të të Fakultetit të Arkitekturës së Universitetit Politeknik të Tiranës, synon krijimin e një projekti me kosto efektive dhe të gatshëm për treg, në përputhje me kërkesat e Konventës Aarhus, duke u bazuar në të drejtën e publikut për informim dhe ankimimin në gjykatë për çështjet e mjedisit

Konkursi është hartuar për t'u dhënë studentëve një mundësi të marrin pjesë përmes punës konkrete për projektimin e brendshëm dhe zbatimin e projektit, të mësojnë nga përvoja e punës në një ekip shumëdisiplinor, që është thelbësore për punën profesionale, partneritetet dhe për krijimin e rrjeteve me profesionistët e qeverisë dhe ekipin e projektit të UNDP-së në Shqipëri. Penalizojë të gjithë ato institucione shtetërore, subjekte private apo individë që do të ushtrojnë aktivitet në kundërvajtje me ligjet dhe standartet e lejuara mjedisore duke dëmтуar shëndetin e tyre.



COP13, CBD: SHQIPËRIA PROGRES TË DUKSHËM PËR ARRITJEN E OBJEKTIVIT GLOBAL PËR MBROJTJEN E BIODIVERSITETIT



“Shqipëria ka bërë progres të dukshëm për arritjen e objektivit global për mbrojtjen e biodiversitetit.” Ky është vlerësimi i bërë në takimin e 13-të ndërkombëtar për Konventën e Biodiversitetit, që po zhvillohet në Cancun, Meksikë pas prezantimit që delegacioni i Ministrisë shqiptare të Mjedisit bërë më 12 dhjetor 2016 .

Sipas planit strategjik, deri në vitin 2020, 168 vendet që kanë firmosur Konventën duhet të kenë shpallur si zona të mbrojtura 17 % të sipërfaqes së vendit dhe të kenë një menaxhim efektiv të tyre.

Në prezantimin e progresit të Shqipërisë u vu në dukje rritja e sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura, hartimi dhe miratimi i

planeve të menaxhimit të tyre, zbatimi i këtyre planeve në praktikë, për të siguruar mbrojtjen e biodiversitetit dhe – plani i aktiviteteve për arritjen e objektivave të Aichi target 11 deri në 2020.


U theksua gjithashtu se Shqipëria është shumë pranë arritjes së objektivit global dhe se deri tani zonat e mbrojtura janë 16.61% e sipërfaqes së vendit. Rezervatet natyrore, parqet kombëtare, monumentet e natyrës që janë pjesë e planit strategjik kombëtar për zonat e mbrojtura, zënë një sipërfaqe prej 471 mijë hektarë, 22 mijë prej të cilave janë sipërfaqe detare.

Në këtë nismë globale sfiduese, e njohur si Dekada e Kombeve të Bashkuara mbi Biodiversitetin 2011-2020,

Ministria e Mjedisit po ndihmohet me disa projekte nga Komisioni Evropian dhe Programet e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin për zbatimin e planeve të menaxhimit të Zonave të Mbrojtura. Për të arritur objektivin global që Zonat e Mbrojtura të jenë sa 17 % e territorit të vendit dhe 6% e pjesës detare, Ministria e Mjedisit do të propozojë 2 zona të reja të mbrojtura: Parkun Natyror Detar të Porto Palermos dhe Parkun Kombëtar të Alpeve.

Programi për Zhvillimin i Kombeve të Bashkuara, UNDP, mbështeti gjithashtu pjesëmarrjen e Shqipërisë për të paraqitur ecurinë e deritanishme dhe objektivat për të ardhmen në COP13.





BioBlitz shkon në shkollën 9-vjeçare "Gjergj Fishta", Lezhë



SEKTORI I TRANSPARENCËS DHE KOMUNIKIMIT
Email: info@moe.gov.al

MBLIDHET GNP: AMENDIMET NE KODIN PENAL PER KRIMET MJEDISORE



Ministria e Mjedisit për amendimet e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Kapitulli IV për Veprat Penale ndaj Mjedisit mbështetur nga prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

I pranishëm në këtë aktivitet, Ministri i Mjedisit, Z. Lefter Koka, tha - :” Kapitulli 4, në kodin penal për veprat penale ndaj mjedisit, nuk është i amenduar qysh në Janar 1995. Ndërkohë që në 20 vite zhvillime të vrullshme, dora e njeriut në vendin tonë ka punuar në dëm të natyrës dhe të Mjedisit.” Ministri Koka theksoi angazhimin serioz të bërë në mbrojtjen e mjedisit në këto 3 vite në disa drejtime duke filluar nga rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe opinionit publik e deri në zbatimin rigoroz të ligjit nga insitucionet ligjzbatuese në varësi të Ministrisë me synimin rritjen e cilësisë së jetës qytetarëve shqiptare dhe trashëgiminë brezave të ardhshëm të një mjedisi të sigurt e të shëndetshëm. Duke e cilësuar vafërinë si armikun kryesor të mjedisit, ai theksoi se niveli i ulët ekonomik dhe varfëria janë faktorë nxitës të fenomenit të dëmtimit të mjedisit dhe natyrës, dhe parandalimi e mbrojtja nga krimi mjedisor është domosdoshmëri, për mos të varfëruar edhe më shumë shoqëinë, duke duke mbetur tërësisht pa burimet natyrore që vendi ka trashëguar.

Më tej Ministri Koka theksoi se - : “Njehsimi dhe përafrimi me legjislacionin e BE –së është një rrugë jo e vështirë, ne në mjedis kemi ecur

me ritme të shpejta, por zbatimi dhe implementimi i tij janë vështirësia kryesore sot në Shqipëri. Çdo institucion ligjzbatues e ka të vështirë të kryejë punën me kuadrin ligjor ku ka ende vakum në këtë drejtim. Konkretisht Inspektoriat Shtetëror i Mjedisit e Pyjeve e ndjen më shumë vakumin ligjor për krimet mjedisore në kodin penal aktual”. Ai nënvizoi faktin se shkeljet e ligjit të mjedisit dhe efektet e tyre përbëjnë një kërcënim serioz për shëndetin publik dhe mjedisin, ekonominë e vendit dhe qytetarët.

Duke iu referuar situatës së menaxhimit dhe administrimit të pyjeve nga bashkitë në vend, ministri Koka bëri një apel për të gjithë kryetarët e bashkive: - “Fatkeqësisht Kryetarët e Bashkive ende nuk janë angazhuar sic duhet për asetin e vyer ekonomik që kanë në pronësi, pyjet. I bëj apel kryebashkiakëve të dalin përtej ambicies politike të një mandati dhe të kontribuojnë në menaxhimin e pyjeve në të mirë të qytetarëve që i kanë votuar”.



Nga ana e tij Z. Bernd Borchardt, Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri shprehu konsideratën e tij për punën e bërë deri tani në sektorin e mjedisit. “Një sektor të cilit Ministri Koka dhe ekipi i tij i janë përkushtuar këto vite dhe shënuar rezultatet e para në qeverisjen mjedisore” – tha z. Borchardt duke theksuar se prezenca e OSBE në Shqipëri, vlerëson se

zhvillimi i qëndrueshëm mjedisor është kyç për sigurinë dhe stabilitetin afatgjatë në nivel vendor, kombëtar dhe rajonal.

Duke u ndalur në problematikën e vendit tonë Z. Borchardt tha se - :”Krimi mjedisor kërcënon burimet natyrore të Shqipërisë dhe është pengesë në rrugën e saj drejt një ekonomie eficiente e punësim të sigurtë”. Ai vijoi duke nënvizuar se OSCE është plotësisht e angazhuar që ta asistojë Grupin Ndërinstitucional kundër Krimit Mjedisor për mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes mjedisore.

Më tej kreu i AKM z. Julian Beqiri prezantoi punën 1 vjeçare të bërë nga grupi ndërinstitucional ngritur me 12 institucione shtetërore (ISHMP, AKZM, AKM, Policia Shtetit, Doganat etj) mbështetur nga prezenca e OSCE në Shqipëri.

Ministria e Mjedisit prej vitit 2015 është duke punuar për amendimet e Kodit Penal për përgatitjen e një Pakete të Krimit Mjedisor, në bashkëpunim të ngushtë me ekspertë vendas dhe ekspertë dhe konsulentë të huaj, si dhe aktorë kryesorë të përfshirë në këtë proces. Synohet që brenda vitit 2016 paketa e krimit mjedisor me amendimet e plota, të dorëzohet pranë Ministrisë së Drejtësisë e cila do të bëjë mendimet përkatëse e do të ndjekë rrugën insitucionale për mendimet respektive deri në fazën finale të miratimit

